

V E N D I M
Nr.17, datë 12.1.2001

**PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS SË TENDERIMIT, PËR SHITJEN E PAKETËS SË
AKSIONEVE, PREJ 94 PËRQINDËSH, TË ZOTËRUAR NGA SHTETI NË “BIRRA
MALTO”, SH.A, TIRANË, DHE PËR SHPALLJEN FITUES TË TENDERIT KANDIDATIN E
RADHËS, “11 SHOQËRI SHQIPTARE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991, “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private, të pavarura dhe privatizimit”, të nenit 3, të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998, “Për privatizimin e shoqërive tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, dhe të kap.XI, pika 4, shkronja “d” të vendimit nr.529, datë 21.8.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin e shoqërive tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, me ndryshimet përkatëse, me propozimin e kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e procedurës së tenderimit, për shitjen e paketës së aksioneve prej 94 përqindësh, të zotëruar nga shteti në “Birra Malto”, sh.a., Tiranë, dhe për shpalljen fitues të tenderit kandidatin “11 shoqëritë shqiptare”.

3. Vendimi nr.491, datë 19.9.2000, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurës së tenderimit për shitjen e paketës së aksioneve në “Birra Malto”, sh.a., Tiranë dhe shpalljen fitues të tenderit të “Birra Peroni”, S.p.a” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta